



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Berat, më: ____ . 04 .2026

RELACION
MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET PNUD DHE
BASHKISË BERAT NË KUADËR TË PROJEKTIT “PROGRAMI RAJONAL PER
DEMOKRACINE VENDORE NE BALLKANIN PERENDIMOR 3 (RELOAD3)”

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat, në kuadër të bashkëpunimit me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), është përfituese dhe partnere në zbatimin e Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3) në Shqipëri. Ky program synon forcimin e demokracisë vendore përmes rritjes së bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve përmes mbështetjes së iniciativave komunitare.

Në kuadër të zbatimit të këtij programi, Bashkia Berat, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 5675, datë 06.10.2025, ka shprehur angazhimin e saj për të bashkëfinancuar projektet e organizatave të shoqërisë civile në masën 30% të vlerës së tyre, angazhim i cili është miratuar më herët me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 78, datë 20.10.2025 “Mbi miratimin e projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (RELOAD3)”.

Në vijim të këtij angazhimi, paraqitet për miratim Marrëveshja e Financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat, e cila, përveç kontributit të mësipërm të bashkëfinancimit në masën 30%, parashikon gjithashtu detyrimin e Bashkisë Berat për të mbuluar edhe Tarifën e Menaxhimit të Programit (GMS) në masën 5%, në përputhje me përcaktimet e Nenit II të Marrëveshjes së Financimit (bashkëlidhur Marrëveshja e Financimit).

Në total, Bashkia Berat do të organizojë tri thirrje publike:

Thirrja Nr. 1, për vitin 2026, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 2, viti 2027, me vlerë totale të projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 3, për vitin 2028, me një vlerë totale prej 4,000,000 lekësh, e cila do të financohet plotësisht nga fondet e Bashkisë Berat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Për rrjedhojë, kontributi total i Bashkisë Berat në kuadër të kësaj marrëveshjeje për Thirjen e Parë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (viti 2026) arrin në vlerën **1,417,500 lekë**, i cili përfshin:

- **1,350,000 lekë** bashkëfinansim (30% e vlerës së projekteve të mbështetura);
- **67,500 lekë** tarifë menaxhimi (GMS 5%).

Ky kontribut do të likuidohet në një këst të vetëm, brenda datës **30 maj 2026**, në llogarinë e përcaktuar të PNUD-it në Marrëveshjen Financiare.

Konkretisht, fondi i bashkisë do të mbështesë këto iniciativa:

Nr.	Emri i organizatës	Titulli i projektit	Kohëzgjatja	Periudha e zbatimit	Vlera Totale e Projektit (Lekë)	Kontributi i Bashkisë (Lekë)	GMS (5 %) (Lekë)	Kontributi total i Bashkisë (Lekë)
1	Shoqata Neë Bridges	Qendra rinore multifunktionale Lapardha: Fuqizimi i të rinjve për angazhim në komunitet	8 muaj	14 Prill 2026 – 15 Dhjetor 2026	ALL 2,500,000	ALL 750,000	ALL 37,500	ALL 787,500
2	The youth of ura	Rijetëzimi i tregut të gjelbër në Berat	8 muaj	14 Prill 2026 – 15 Dhjetor 2026	ALL 2,000,000	ALL 600,000	ALL 30,000	ALL 630,000
	Total				ALL 4,500,000	ALL 1,350,000	ALL 67,500	ALL 1,417,500

Zbatimi i programit dhe administrimi i fondeve do të kryhen nga PNUD, në përputhje me rregullat, procedurat dhe standardet ndërkombëtare të menaxhimit financiar dhe auditimit, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në përdorimin e fondeve.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij programi për forcimin e demokracisë vendore, fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, propozohet:

- miratimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat në kuadër të programit RELOAD 3.
- Fondi i nevojshëm prej 1,417,500 lekë për bashkëfinansimin e Bashkisë Berat për vitin 2026 do të përballohet nga buxheti i vitit 2026, Fond për Bashkëfinancime në projekte me financim të huaj në fushën e shërbimeve publike.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

**KRYETARI I BASHKISË
ERVIN CECA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. _____ Prot.

Berat, më ____ . ____ 2026

Lënda : Dërgim informacioni mbi procedurën e inventarizimit të aseteve viti 2025

**DREJTORIA E FINANCËS
BASHKIA BERAT**

Në zbatim të Ligjit nr. 10 296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Udhëzimin nr.30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, urdhërit te brendshëm nr.4 datë 03.01.2024 “Për ngritjen e komisionit për kryrjen e inventarizimit fizik të aseteve në qytetin e Beratit”, urdhërit te brendshëm nr.121 datë 07.10.2025 “Për ngritjen e komisionit për kryrjen e inventarizimit fizik të aseteve në qytetin e Beratit” i ndryshuar, urdhërit te brendshëm nr.3 datë 03.01.2024 “Për ngritjen e komisionit për kryrjen e inventarizimit fizik të aseteve në Njësitë Administrative Berat” , urdhërit te brendshëm nr.122 datë 07.10.2025 “Për ngritjen e komisionit për kryrjen e inventarizimit fizik të aseteve në Njësitë Administrative Berat” i ndryshuar, urdhërit të brendshëm nr.6 datë 03.01.2024 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të Aktiveve të propozuara për daljen nga përdorimi”, urdhërit të brendshëm nr.119 datë 07.10.2025 “Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të Aktiveve të propozuara për daljen nga përdorimi” i ndryshuar, urdhërit të brendshëm nr.5 datë 03.01.2024 “Për ngritjen e Komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit” urdhërit të brendshëm nr.120 datë 07.10.2025 “Për ngritjen e Komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit” i ndryshuar,

Komisioni i inventarizimit gjatë vitit ushtrimor kryen procedurën e inventarit nëpërmjet verifikimit fizik dhe cilësor të aktiveve në ngarkim dhe harton procesverbalet përkatëse për cdo shtesë apo levizje të brendshme ndërmjet institucioneve arsimore dhe stafit arsimor.

Pas procesit të inventarizimit të aktiveve propozuara nga komisioni i inventarizimit për daljen nga përdorimi, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj drejtorie, bazuar në gjendjen faktike të aktiveve të identifikuara për vlerësim të nxjerra nga Komisioni i Inventarizimit mbi inventarizimet fizike të kryera për periudhën Janar-Dhjetor 2025 në të gjitha institucionet që Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat menaxhon si shkolla, kopshte, çerdhe, konvikte, Qendra Kulturore e Fëmijëve, zyrat e administratës në qytet dhe në 4 Njësitë Administrative të Bashkisë Berat, ka hartuar proces verbale të vlerësimit të aseteve dhe relacione përmbledhëse.

Bazuar sipas kritereve të pikës 103 Udhëzimi nr.30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” komisioni i vlerësimit harton procesverbalet me argumentimet dhe arsyet përkatëse.

Në përfundim të këtij procesi Komisioni i Asgjësimit ka kryer procedurën e asgjësimit fizik të aseteve të vlerësuara si dalje nga përdorimi. Vlerën më të lartë të asgjësimit e kanë Njësitë Administrative veçanërisht Njësia Administrative Otllak ku shkolla e mesme e bashkuar ‘Koço Brisku’ Lapardha është shembur dhe po rindërtohet nga e para.

Nga nëpunësi zbatues janë kryer veprimet në pasqyrat financiare për zbritjen e vlerës së aktiveve të dala jashtë përdorimit sipas llogarive ekonomike.

Totali i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit për vitin 2025 është si më poshtë :

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi I Institucionit	Totali I Aktiveve Afatshkurtra Llogaria 327 (Inventari I imet)	Totali I Aktiveve Afatgjata Llogaria 218 (Inventari ekonomik)	Totali I Aktiveve Afatgjata Llogaria 214 (Makineri&Paisje)
		Viti 2025	Viti 2025	Viti 2025
1	Cerdhja Nr.1	89,335		
2	Cerdhja Nr.5	54,155		28,756
3	Cerdhja Nr.7	19,970		

4	Cerdhja Uznove			
5	Kopshti 1 Qershori	66,410		39,042
6	Kopshti 10 Korriku	28,755		146,604
7	Kopshti 28 Nentori			792,000
8	Kopshti Clirim nr 1	39,872		92,717
9	Kopshti Clirim nr 2	45,561		6,302
10	Kopshti Barikada 2+3	7,630		105,694
11	Kopshti Llambrini Puli			
12	Kopshti Donika Kastrioti	29,034		137,116
13	Kopshti Uznove	40,196		
14	Shkolla mesme Babë Dudë Karbunara			2,969,551
15	Shkolla mesme Kristaq Capo	12,110		174,980
16	Shkolla e bashkuar Shyqyri Lakra	132,497		
17	Shkolla 9-vjecare Xhemal Çekini,Uznove	30,352		
18	Shkolla 9- vjecare 1 Maj	19,924		259,229
19	Shkolla 9-vjecare Thimi Tani	40,163		220,127
20	Shkolla 9-vjecare 22 Tetori			
21	Shkolla 9-vjecare Mehmet Ali Vrioni			
22	Shkolla 9-vjecare Zihni Toska	22,698		268,987
23	Shkolla 9-vjecare Ajet Xhindole	41,316		1,154,479
24	Shkolla 9-vjecare 28 Nentori	67,318		58,560
25	Administrata e Drejtorise se Arsimit	157,659		35,600
26	Konvikti"Kristo-Isak"	730,994		

27	Kuzhina Qendrore	166,961		660,000
28	Njesia Adm. Velabisht	630,793	67,495	1,433,256
29	Njesia Adm. Sinje	340,364	281,348	43,500
30	Njesia Adm. Roshnik	277,704	26,900	6,980
31	Njesia Adm. Otllak	1,058,266	7,184,242	1,342,671
	TOTAL	4,150,037	7,559,985	9,976,151

Përgjegjëse Sektorit Ekonomik

Enkeleda Malo

DREJTOR

Klodiana Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtuar : KËSHILLIT TË BASHKISË

DREJTORISË SË FINANCËS BASHKIA BERAT

INFORMACION

MBI REZULTATET E INVENTARIZIMIT FIZIK TË ASETEVE TË PËR VITIN 2025

Të nderuar !

Mbështetur në ligjin Nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “ dhe në zbatim Ligjin nr. 10 296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 120, “Për efekte ekonomike dhe financiare të nxjerrjes nga përdorimi, Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të informojnë këshilltarët e njësive vendore”. Nisur nga koha e gjatë e përdorimit të aseteve kanë bërë të mundur plotësimin e kohës së shfrytëzimit, normat e amortizimit në fuqi dhe gjendjen faktike që janë nuk mund të riparoheshin. Janë kosumuar, thyer e dëmtuar në një shkallë të tillë që është e pa mundur të kthehen në gjendje pune. Komisioni i vlerësimit këto materiale i ka propozuar për miratim për aktivet afatshkurtra nxjerrjen përfundimisht jashtë përdorimit. Përgjegjësi i Sektorit të Gjelbërimit **Z. Adriatik Meçe** këto nëpërmjet asgjësimit përfundimtar duke ndryshuar formën e tyre fillestare nëpërmjet thyerjes, gproposjes apo djegies duke zbatuar kërkesat e pikës 109 të udhëzimit nr 30 datë 27.11.2011.

Në zbatim të pikave të mësipërme të udhëzimit mbi rezultatet e inventarizimit fizik të asete të Agjencisë së Shërbimeve Publike për vitin 2025.

Rezultatet e inventarizimit te vitit 2025

Llogaria 327

NR	Agjencia e Sherbimeve Publike /Sektori i Gjelberimit		Lista e materialeve jashte perdorimit Llog 327 Viti 2025			
	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera	Arsyeja
1	Jelek	cope	27	900	24300	Demtuar
2	Pelerin shiu	cope	1	1980	1980	Demtuar
3	Cizme te shkurtra	cope	5	720	3600	Demtuar
4	Cizme	cope	1	1071	1071	Demtuar
5	Kominoshe	cope	5	1920	9600	Demtuar
6	Gershere krasitese	cope	1	960	960	Demtuar
8	Zorre uji	ml	50	220	11000	Demtuar
9	Cizme	cope	29	840	24360	Demtuar
10	Gershere krasitese te medha	cope	2	1440	2880	Demtuar
11	Jelek	cope	20	480	9600	Demtuar

12	Vazo te vogla	cope	300	48	14400	Demtuar
13	Rrip sigurimi	cope	1	3000	3000	Demtuar
14	Kominoshe	cope	50	1800	90000	Demtuar
15	Kominoshe	cope	3	3840	11520	Demtuar
17	Zorre Ø40	ml	83	318	26394	Demtuar
18	Kacavid yll	cope	2	180	360	Demtuar
20	Fishrk Brave	cope	1	480	480	Demtuar
21	Dryn	cope	1	360	360	Demtuar
22	Morset	cope	1	5800	5800	Demtuar
23	Tavoline	cope	1	16000	16000	Demtuar
24	Pelerine	cope	11	1020	11220	Demtuar
25	Kominoshe	cope	1	2275	2275	Demtuar
26	Zorre e zeze	cope	49	114	5586	Demtuar
27	Karroce dore	cope	1	5400	5400	Demtuar
28	Sharre dore krasitese	cope	1	45	45	Demtuar
29	Jelek	cope	2	791	1582	Demtuar
30	Shilte damasku	ml	4	1500	6000	Demtuar
31	Hapese vrimash	cope	1	502	502	Demtuar
32	Kapese dokumentash makineri	cope	1	1500	1500	Demtuar
33	Kapese aktesh makineri	m	1	900	900	Demtuar
34	Bateri laptopi	cope	1	10000	10000	Demtuar
35	Flesh	cope	7	1000	7000	Demtuar
36	Makine llogaritese	cope	3	1000	3000	Demtuar
37	Maus	cope	1	1000	1000	Demtuar
38	makine Kapese dokumentash	cope	5	500	2500	Demtuar
39	Rezistence	cope	1	3500	3500	Demtuar
40	Sobe ngrohje	cope	1	10000	10000	Demtuar
41	Bela	cope	1	360	360	Demtuar
42	Kepuce	cope	11	1740	19140	Demtuar
43	Jelek	cope	3	960	2880	Demtuar
44	Jelek	cope	3	996	2988	Demtuar
45	Kominoshe	cope	2	1440	2880	Demtuar
46	Cizme	cope	7	924	6468	Demtuar
47	Sfurk	cope	1	540	540	Demtuar
48	Lopate	Cope	1	780	780	Demtuar
49	Kose bari	cope	1	1800	1800	Demtuar
50	Zorre uji	ml	17	318	5406	Demtuar
51	Mistri	Cope	1	600	600	Demtuar
53	Pelerine	cope	3	1200	3600	Demtuar
	Shuma Totale				377.117	

Agjencia e Sherbimeve Publike /Sektori i Sherbimeve						
Lista e materialeve jashte perdorimit Llog 327 Viti 2025						
Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera	Arsyeja
1	Kazem	Cope	2	1080	2160	Demtuar
2	Prize treshe	Cope	1	480	480	Demtuar

3	Pompe sperkatese	Cope	1	4000	4000	Demtuar
4	Pompe sperkatese	Cope	1	3600	3600	Demtuar
5	Meter shirrit	cope	1	320	320	Demtuar
6	Kazem	cope	5	1260	6300	Demtuar
7	Lopata +Bisht	cope	24	792	19008	Demtuar
8	Koster + bisht	cope	15	720	10800	Demtuar
9	Kazem + bisht	cope	5	960	4800	Demtuar
10	Kazem + bisht	Cope	8	840	6720	Demtuar
11	Leve Guri	Cope	1	780	780	Demtuar
12	Lopata +bisht	Cope	31	1020	31620	Demtuar
13	Kosore me bisht	Cope	2	1800	3600	Demtuar
14	Kreher metalik	cope	2	960	1920	Demtuar
15	Vare	cope	1	3000	3000	Demtuar
17	Vare	cope	1	187	187	Demtuar
18	Vare	Cope	1	1100	1100	Demtuar
19	Gome karroce	Cope	3	1800	5400	Demtuar
20	Vare	Cope	1	3600	3600	Demtuar
21	Pompe me bateri 18l	Cope	1	16800	16800	Demtuar
22	Pompe me bateri 50l	cope	1	14400	14400	Demtuar
23	Gome karroce	cope	3	2280	6840	Demtuar
24	Kokore mbrojtese	cope	5	480	2400	Demtuar
25	Kokore mbrojtese	cope	5	600	3000	Demtuar
26	Karroce + gome	Cope	3	7200	21600	Demtuar
27	Jelek	cope	40	1080	43200	Demtuar
28	Karroce + gome	cope	4	6000	24000	Demtuar
29	Karroce dore	cope	2	4200	8400	Demtuar
30	Goma 255/60/18	cope	4	22000	88000	Demtuar
31	Goma 245/70/16	Cope	5	8400	42000	Demtuar
32	Goma 65/16	Cope	2	14400	28800	Demtuar
33	Goma FV 10R22.5	Cope	2	30000	60000	Demtuar
34	Goma 295/80/r22.5	Cope	4	30000	120000	Demtuar
35	Goma 295/80/r22.5	cope	4	38000	152000	Demtuar
36	Goma te para 400/70	cope	2	55000	110000	Demtuar
37	Mashe saldimi	cope	1	375	375	Demtuar
38	Pince saldimi	cope	1	15	15	Demtuar
39	Malla	cope	1	444	444	Demtuar
40	Kazem gur	cope	1	480	480	Demtuar
41	Kosore	cope	1	480	480	Demtuar
42	Kazem guri	cope	1	700	700	Demtuar
43	Karroce	cope	2	3840	7680	Demtuar
44	Kazem	cope	4	1200	4800	Demtuar
45	Ngrohesh elektrik	cope	2	5000	10000	Demtuar
46	Cizme Llastiku	cope	2	1440	2880	Demtuar
47	Karroce	cope	1	5040	5040	Demtuar
48	Zinxhira sharre	Cope	6	2400	14400	Demtuar

49	Kuzhinete pompe	Cope	5	1440	7200	Dentuar
50	Saracineska	Cope	10	1080	10800	Dentuar
51	Dalte	Cope	2	480	960	Dentuar
	Shuma				917.089	

Komisioni i Inventarizimit pranë kësaj drejtorie bazuar në gjëndjen faktike të aktiveve afat gjata dhe afat shkurtra të Agjencisë së Shërbimeve Publike, normave të amortizimit, afatit të skadencave, vitit të vënies në punë të aktiveve, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve, në raport kosto/përfitim për një veprim të tillë harton listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim.

Komisioni i Inventarizimit nuk ka identifikuar aktive për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve për vitin 2023.

Komisioni i Inventarizimit pranë kësaj drejtorie bazuar në gjëndjen faktike të material në përdorim , inventari e llogarisë 327 duke u bazuar në gjëndjen e tyre të dëmtuar dhe nuk mund të përdoren, harton listën e materialeve të identifikuar për nxjerrje jashtë përdorimit për vitin 2025, me vlerë **1.294.206 lekë**.

Shefe Finance

Kamberije Selimi

Drejtori

Joana Melengu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE,UJRAVE DHE SHERBIMIVETERINAR.

Nr _____ Prot

Berat,më _17.04.2026

RELACION

Nr 1 Date 17.04.2026

Lenda :Relacion mbi vleresimin e aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata te Drejtorise se Bujqesise, AdministrimittePyjeve, Ujrave e SherbimiVeterinar.

Drejtuar : Keshillit te Bashkise. Bashkia Berat.

Me ane te ketij relacioni te meposhte m ju informojme ne lidhje me proceduren e ndjekur ne lidhje me procesin e inventarizimit dhe vleresimit te inventareve per vitin 2024.

Mbeshtetur ne Urdherin e Ministrise se Financavr UMF Nr 30 date 27/12/2011 “Per menaxhimin e asetete ne njesite e sektori tpublik”neni 95-109 , u ngriten komisionet per kryerjen e e inventarit me nr urdher nr 44 date 13.11.2025,komisioni I vleresimit te aktiveve i ngritur me urdher te brendeshem nga titullari me numer te urdherit Nr 44 date 13.11.2025, , dhe komisioni i asgjesimit I ngritur me urdher nr 45 date 13.11.2025.

Fillimisht u krye puna nga komisioni i inventarizimit i cili paraqiti materialet per vleresim:

Pasi perfundoj dhe u miratua procedura e kryerjes se inventareve nga komisioni i inventarizimit ,nisi nga puna procedura e vleresimit .

Ky komision verifikoi te gjitha materilaet nje per nje sipas listes, te cilat ishin propozuar nga komisioni i inventarizimit per tu vleresuar.

Gjate vleresimit faktik te aktiveve u argumentuan me arsyet per vleresim per secalin aktiv afatshkurter.

U moren parasysh arsyet e meposhteme.

- Nese eshte i nevojshem apo jo per veprimtarine e njesise
- Nese nuk rezulton i nevojshem per njesine , a eshte ne gjendje te mire fizike dhe ka mundesi perdorimit e metejsheem ne njesit e tjera.
- Nese duhet te nxiret perfundimisht jashte perdorimit nepermjet shitjes si material mbeturine apo asgjsimin perfundimtar.

Vleresimi i aktiveve afatshkurter u be sipas kriterëve te nenit 103 te ketij udhezimi .dhe u arrit ne perfundimin si me poshte per sejcilin material sipas listes.

I .Materialet e meposhteme e kane humbur cilesine e tyre te caktuar ne standartet shteterore ,dhe nuk mund te perdoren si te zhvleftesuara ose per qellime te tjera ne formen qe jane.

Nje pjese e materilaëve te meposhteme jane demtuar ne shkalle te tille qe eshte e pamundur te kthehen ne gjendje pune ne permjet riparimit..

Komisioni i vleresimit arriti ne perfundimin se materialet e listuar me poshte nuk kane me mundesi perdorimit e metejshem ne njesi dhe vleresohen si material per tu asgjesuar, duke u groposur ne land fillillin e percaktuar nga Bashkia Berat.

Lista e materialeve per asgjesim llog 327.1 Inventar i imet.ne vlere **317489** **treqind e shtatembedhete mije e katerqind e tetedhete e nente leke** sipas tabelës bashkangjitur.

N r.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera kontabel	Arsyja per propozim "Nxjerrje jashte perdorimit"
1	Syze	cope	18	216	3888	Dëmtuar
2	Doreza pune	Cope	200	108	21600	Dëmtuar
3	Kapele	Cope	21	240	5040	Dëmtuar
4	Kominoshe	Cope	14	1920	26880	Dëmtuar
5	jelek	cope	18	600	10800	Dëmtuar
6	Kepuc pune	cope	8	2400	19200	Dëmtuar
7	Uniforma pune	Cope	16	2880	51840	Dëmtuar
8	Pulovra sektori pyjor	Cope	8	2400	19200	Dëmtuar
9	Bluza me krah te shkurter	Cope	8	1440	11520	Dëmtuar

10	kepuc	cope	9	2160	19440	Demtuar
11	Goma	Cope	4	20000	80000	Demtuar
12	Jelek fosforishent	Cope	2	1090	2180	Demtuar
13	Veshje motoshare	Cope	1	2064	2064	Demtuar
14	Cizme	Cope	6	684	4104	Demtuar
15	Pompe sperkatje	Cope	3	12000	36000	Demtuar
16	Cizme te gjata	Cope	1	919.32	919	Demtuar
17	Cizme	Cope	2	684	1368	Demtuar
18	Sfurk	Cope	1	630	630	Demtuar
19	Sepate	Cope	1	816	816	Demtuar
	Shuma				317489	

DREJTORI

BLEDAR CILI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

GRUPI I PUNËS PËR MATJEN E PERFORMANCES

Nr. _____ .Prot.

Berat, më ____/____/2026

RELACION SHPJEGUES

Raporti i Performancës 2025 paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Berat në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat Publike Vendore” dhe Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës. Ky raport synon të ofrojë një vlerësim të plotë e të strukturuar mbi mënyrën se si bashkia ka realizuar funksionet dhe shërbimet publike gjatë vitin 2025, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe bazë të qartë për vendimmarrje.

Dokumenti analizon rezultatet në 11 fusha funksionale, përfshirë arsimin parauniversitar, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen nga zjarri, ujitjen dhe kullimin, administrimin e pyjeve dhe kullotave, shërbimet sociale, qeverisjen e mirë dhe financat vendore. Në mënyrë të përgjithshme, raporti tregon se bashkia ka ruajtur stabilitet në ofrimin e shërbimeve bazë dhe ka shënuar përmirësime të rëndësishme, sidomos në menaxhimin e mbetjeve, rritjen e efikasitetit të shërbimeve sociale dhe përmirësimin gradual të rrjetit ujitës. Nga ana tjetër, sfida të tilla si mungesa e planeve sektoriale, nevoja për modernizimin e shërbimit zjarrfikës dhe administrimi i fondit pyjor mbeten prioritare për ndërhyrje të mëtejshme.

Raporti përmban analizë të qartë të treguesve, identifikon vështirësitë strukturore dhe përcakton rekomandime konkrete për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në periudhat e ardhshme. Ai shërben si një instrument orientues për planifikimin afatmesëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës vendore.

Raporti i Performancës 2025 paraqet një pasqyrë të përgjithshme pozitive të funksionimit të Bashkisë Berat, duke evidentuar progres në disa fusha kyçe dhe duke përcaktuar drejtimet e punës për vitet në vijim. Për këto arsye, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i raportit si dokument zyrtar i vlerësimit të performancës së bashkisë për vitin 2025.

Ju faleminderit,

Kryetar Grupi : Arisa Toska
Koordinator: Marius Qytyku
Specialist: Jorida Papa

KRYETARI I BASHKISË
ERVIN CECA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

RELACION

“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. LULJETA KAÇELI, BANESA E SË CILËS ËSHTË DËMTUAR NGA SHIRAT, NGA BUXHETI I VITIT 2026 NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “EMERGJENCAT CIVILE”

Të nderuar këshilltarë,

Në datën 18.02.2026, si pasojë e reshjeve të dendura dhe rrëshqitjes së tokës, është shembur muri mbajtës i banesës së znj. Luljeta Kaçeli, duke krijuar rrezik serioz për shembjen e banesës së saj, si dhe për banesën përballë. Fatmirësisht, nuk ka pasur dëme në njerëz. Pas administrimit të kërkesës së z. Ermal Kaçeli, me nr.210 prot., datë 18.02.2026, komisioni i ngritur me Urdhrin nr.167, datë 24.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga shirat e datës 18.02.2026”, për banesën me pronare znj. Luljeta Kaçeli, e ndodhur në lagjen “Muzakaj”, Lagja nr. 1, Bashkia Berat, ka kryer verifikimin në terren.

Në bazë të konstatimit fizik, komisioni ka hartuar procesverbalin e dëmeve të shkaktuara, në mbështetje të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Procesverbali i konstatimit është përcjellë në Këshillin e Qarkut me shkresën nr. 1255/1 prot., datë 26.02.2026, për vlerësimin e dëmeve sipas legjislacionit në fuqi.

Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut ka përfunduar vlerësimin e dëmeve në banesën e znj. Luljeta Kaçeli dhe e ka përcjellë atë në Bashkinë Berat me shkresën nr.235/1 prot., datë 26.03.2026.

Në mbështetje të preventivit të hartuar nga grupi i ekspertëve, rezulton se dëmet janë si më poshtë:

-Punime ndërtimore: 319,478 lekë

Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në VKM nr. 329, datë 16.05.2012, Kreu III, pika 1, 3, shkronja “ç”, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e 50 % të vlerës së llogaritur si ndihmë e menjëhershme financiare për:

Familjen e znj. Luljeta Kaçeli në vlerën 159,739 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

Ndihma financiare do të përballohet nga buxheti i vitit 2026 në Ministrinë e Mbrojtjes, Programi “Emergjencat Civile”, për sigurimin e jetesës dhe kushteve të përkohshme të banimit, si dhe për përballimin e situatës emergjente..

DREJTOR I MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Sokol Toska



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

“MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.93, DATË 28.12.2021, TË KËSHILLIT BASHKIAK, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E BERATIT”, TË NDRYSHUAR”.

Të nderuar Këshilltarë!

Ky relacion paraqitet përpara jush me qëllim miratimin e ndryshimeve në Paketën Fiskale vendore, në vendimin nr.93, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e beratit”, të ndryshuar, konkretisht ndryshimin e terminologjisë së përdorur për klasifikimin e bizneseve, në funksion të tarifimit dhe taksimit vendor, në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor.

Situata aktuale

Në Paketën Fiskale aktuale të Bashkisë Berat, bizneset janë të ndara në dy grupe:

- Biznese që i përkasin **tatimit të thjeshtuar mbi fitimin**;
- Biznese që i përkasin **tatimit mbi fitimin**.

Kjo ndarje ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me klasifikimin tatimor sipas legjisllacionit të mëparshëm, ku kriteri kryesor ishte niveli i xhiros vjetore (deri në 8 milion lekë dhe mbi 8 milion lekë).

Me hyrjen në fuqi të Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", kjo ndarje nuk ekziston më. Ligji i ri parashikon ndarjen në:

- Tatim mbi të ardhurat personale;
- Tatim mbi të ardhurat e korporatave.

Si rrjedhojë, do të bëhet përshtatja e paketës fiskale ku do të ruhet i njëjti kriter me ndarjen e mëparshme, niveli i xhiros vjetore (deri në 8 milion lekë dhe mbi 8 milion lekë).

Klasifikimi i bizneseve për efekt tarifimi vendor do të bazohet në **xhiron e realizuar në vitin paraardhës**, sipas të dhënave zyrtare të deklaruara nga subjekti në sistemin tatimor.

Ky ndryshim ka karakter thjesht terminologjik dhe administrativ dhe nuk sjell ndryshim në nivelin apo mënyrën e llogaritjes së taksave dhe tarifave vendore.

Propozimi për ndryshim

- Për të siguruar vazhdimësinë e tarifimit, qartësinë administrative dhe përputhjen me ligjin e ri, propozohen ndryshimet e terminologjisë ku termi “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” zëvendësohet me “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8

(tetë) milion lekë” dhe termi “Subjekte të tatimit mbi fitimin” zëvendësohet me “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Konkretishtë si më poshtë:

Kreu I, Neni 40 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“III.Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II. “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“III.Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 41, pika 3

Ishte:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapsirave publike për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapsirave publike për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 41, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu II, Neni 44 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II, a.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“II, c. Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II, a “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“II, c “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 45, pika 3

Ishte:

Tarifa e ndrçimit publik për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e ndrçimit publik për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 45, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu III, Neni 48 ,Pika 2, kategoritë dhe nënkategoritë, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“III.Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“ II. “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“III.Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 49, pika 3

Ishte:

Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 49, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “ Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu IV, Neni 52 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II, a.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“II, c. Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II, a “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“II, c Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 53, pika 3

Ishte:

Tarifa për infrastrukturen arsimore për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa për infrastrukturen arsimore për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 53, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “ Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Efekti mbi biznesin

Ndryshimi i propozuar:

- Nuk sjell rritje tarifash për asnjë kategori biznesi;
- Nuk krijon barrë shtesë financiare;
- Siguron trajtim të drejtë dhe transparent, bazuar në xhiron reale të biznesit;
- Eliminon paqartësitë ligjore dhe administrative

Rivlersimi i detyrimeve për vitin 2026

Për vitin 2026, në këstin e dytë të detyrimit vendore do kryhet rivlersimi i kategorisë së subjekteve, mbi bazën e xhiros vjetore të realizuar gjatë vitit 2025, sipas të dhënave zyrtare të deklaruara në sistemin tatimorë.

Ky proces synon vendosjen e detyrimit në përputhje me kapacitetin ekonomik të cdo subjekti dhe garantimin e trajtimit të barabartë fiskal.

Në këtë kuadër:

- Subjekteve që janë tarifuar fillimisht në kategorinë e tatimpaguesve me përgjegjesi tatim mbi fitimin, por që rezultojnë me xhiro vjetore nën 8 (tetë) milion lekë, do t'u bëhet rillogaritja e detyrimit dhe diferenca e paguar më tepër do të kompensohet në këstin e dytë, sipas nivelit që u takon bazuar në xhiron reale.
- Subjekteve që janë tarifuar fillimisht në kategorinë e tatimpaguesve me përgjegjesi tatim të thjeshtuar mbi fitimin, por që rezultojnë me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë, do t'u kryhet rivlerësimi parkatës dhe në këstin e dytë do të likujdohet diferenca e detyrimit të papaguar.

Përfundim

Ndryshimi i propozuar ka si qëllim të vetëm përshtatjen e Paketës Fiskale të Bashkisë Berat me kuadrin e ri ligjor, pa ndryshuar nivelin e tarifimit dhe pa cenuar interesat e biznesit apo të buxhetit vendor.

Miratimi i këtij ndryshimi do të garantojë vazhdimësinë e administrimit fiskal vendor, qartësinë ligjore dhe korrektësinë në trajtimin e subjekteve tatimpaguese.

Njekohësisht, ky standartizim është reflektuar dhe përshtatur edhe nga një sërë njësisish të tjera të vetëqeverisjes vendore në vend, në kuadër të përafrimit të paketave fiskale me legjislacionin në fuqi.

Për këto arsye, propozohet miratimi i ndryshimeve të mësipërme nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Berat.

Faleminderit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJËRAVE DHE
SHËRBIMIT VETERINAR**

Nr ___prot

Berat ,më/04/2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAKË

Të nderuar këshilltare!

Në mbështetje të ligjit të Shërbimit Veterinar në Republikën e Shqipërisë nr. 10465 datë 29.09.2011 neni 56, I ndryshuar me ligjin nr. 71 datë 04.06.2020 neni 21, pika 1, shkronja a, shkronja ç si dhe V.K.M nr 475 datë 30.07.2021 për detyrat funksionale të Shërbimit Veterinar të Njësive të Qeverisjes Vendore kreu III, "Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenëve dhe maceve endacake", ligjit Nr 139 /2015 "Për qeverisjen vendore" kreu VII "Funksionet dhe kompetencat e Njesive të vetqeverijes Vendore,,neni 27 "Funksionet e Bashkive në fushën e Bujqësië,,Zhvillimit Rural ,pyjeve, kullotave publike,natyrës dhe biodiversitetit", shkresave të ardhura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorise se Përgjithshme te Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit me nr prot 5848/3 datë 01.12.2023 "Mbi modulën për regjistrimin dhe identifikimin e gjithë kafshëve të rrugës(qenë dhe mace), shkresës me nr prot 1088 datë 11.10.2024 "Kërkese për bashkëpunim për të dhënat për kafshët endacake të menazhura nga ana e Bashkisë " si dhe duke u nisur nga ankesat e shumta të qytetarve, drejtues të institucioneve si kopshte,shkolla, poliklinika e qytetit si dhe qendra shëndetsore që na vijnë për qentë endacakë ku femije apo gra kanë frike të dalin në rrugë, problemet dhe rreziqet (pasi mbartin sëmundje te rrekishme sidomos qentë për komunitetin e BashkisE BERAT ku kemi patur raste edhe të kafshimeve të tyre kerkojmë Mbeshtetjen tuaj me nje fond për trajtimin e kafshëve endacake..

Theksojmë se qentë nëpër rrugë janë problem dhe bien në sy për keq dhe për turistët e huaj duke prishur imazhin e qytetit tonë.

Në bazë të ligjit të Shërbimit Veterinar si dhe duke parë eksperiencën e Bashkive të tjera, strategjia që do të ndiqet për të zgjidhur problemin e qenve të rrugës është metoda KSVL (Kapja, Sterilizimi .Vaksinimi, Leshimi) që këshillohet nga ĚSPA(Ěorld Society for the Proctetion of Animals) e cila ka funksionuar në të gjitha vendet e zhvilluara sipas organizates botërore si OBSH, OIE dhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e kafshëve të rrugës duke lidhur kontratë me operatorë privatë për të cilin kemi projektin në vlerën lekë 1 000 000(nje milion leke).

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj për miratimin e këtij projekt-vendimi, pasi si e theksuam më lart trajtimi I kafshëve endacake ka shumë rëndesi për jetën e komunitetit sepse kafshët endacakae janë të pavaksinuara dhe mbartin sëmundje të rrezikshme si tërbimi, leishmanozia ,sëmundje parazitare etj, dhe sterilizimi I tyre do të shmangë fenomenin e shumimit në menyrë të pakontrolluar do të sjelli ulje të numrit të qenve në rrugë .

I Propozojmë Këshillit të Bashkisë miratimin e këtij relacioni.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar

Bledar Çili (Drejtor Drejtorisë)

Guxim Toska (Specialist Veteriner)

Jurist:Marinela Çifliku

Financa:Thimie Hoxha

Makbule Muçaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJËRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR

TRAJTIMI I QENËVE ENDACAKE (TË RRUGËS)

❖ QENTË NË KOMUNITET

Kafshët kanë qënë gjithmonë një pjesë mjaft e rëndësishme e qytetërimit tonë. Jeta e cdo kafshe ka një rëndësi të madhe, si nga pikëpamja etike ashtu edhe e ekuilibrit natyror që egzistenca e tyre garanton.

Kafsha ka një rol në dinamikën e natyrës dhe për këtë arsye ka të drejta të cilat burojnë nga fakti që është qenie e gjallë.

Për më shumë se 10.000 vite, qentë kanë bashkëjetuar me njerëzit, duke ofruar shumë të mira për ta. Përkundër të mirave, mungesa e kontrollit të qenve si kafshë shoqëruese, mund të shkaktojë shqetësime në komunitet. Këto shqetësime përfshijnë rritjen e numrit të qenve endacak, gjë që rrezikon shëndetin dhe sigurinë publike, dhe mirëqenien e vet kafshëve që jetojnë në rrugë.

❖ DINAMIKA E QENËVE NË KOMUNITET

Dinamika e popullsisë së qenve endacak krijohet me nën-popullsi të ndryshme të qenëve në rrugë, që bashkëveprojnë/riprodhohen dhe formojnë tërë popullsinë e qenëve endacak. Kjo dinamikë merr parasysh proceset e braktisjeve, lindjeve, vdekjeve dhe riprodhimit për të kuptuar mënyrën se si qentë hyjnë dhe largohen nga kjo popullsi. Qentë si kafshë shoqëruese (ang. ‘companion animal’ ose ‘pet’) zakonisht blihen nga dyqanet e kafshëve apo dhurohen nga ndonjë mik apo familjar. Qentë si kafshë shoqëruese, normalisht duhet të mbahen me përgjegjësi të plotë duke iu ofruar strehim të sigurtë

Pavarësisht se nuk ekzistojnë të dhëna empirike, burimet kryesore të qenëve endacak në qytetin tone janë :

1. Braktisja e qenëve dhe këlyshave të pa dëshiruar, nga shumë pronarë.
2. Shumimi dhe shitja e pakontrolluar nga mbarështuesit e pa regjistruar dhe pa licencuar,
3. Importi jashtëligjor i kafshëve shoqëruese, dhe
4. Riprodhimi i vazhdueshëm i qenve të pa kastruar/sterilizuar .

❖ Problematikat nga qentë e rrugës.

Qentë e rrugës janë një problem gjithmonë aktual në rrugët e qyteteve dhe jo vetëm në qytetin e Beratit . Si në qendër ashtu edhe në periferi mund të shohësh një grup prej 5-6 qensh ku disa prej tyre enden në brendësi të lagjeve. Duke jetuar në kushte të këqija dhe duke u ushqyer me mbeturina, ata bëhen bartës të shumë sëmundjeve të rrezikshme, të cilat mund të transmetohen edhe te njeriu. Qentë e rrugëve, të njohur në literaturë shkencore si qentë e lirë , janë qen të pakonfirmuar që jetojnë në qytete. Ata jetojnë pothuajse kudo që ekzistojnë qytetet dhe lejon popullata lokale njerëzore. Qentë e rrugës mund të jenë qenët e humbur, kafshët shtëpiake të cilat janë larguar ose braktisen nga pronarët e tyre, ose mund të jenë qentë e rrugës që nuk kanë qenë kurrë në pronësi.

- Mbi popullimi i qenve të rrugës mund të shkaktojë probleme për shoqëritë në të cilat ata jetojnë. Megjithatë, kafshimet nga qentë mund të ndodhin kur qentë janë duke u përpjekur të bashkohen ose të luftojnë mes vete, ose janë të uritur atëherë këmbësorët dhe njerëzit e tjerë në afërsi mund të kafshohen më lehtë.
- Qenve ju pëlqen të prishin koshat e hapur të mbeturinave duke i shpërndarë ato në rrugë. Qentë e braktisur jetojnë në kope dhe shpesh herë agresohen me njëri tjetrin duke shkaktuar zhurmë të madhe dhe shqetësuese si dhe frike për banorët .Jo të gjithë qentë janë miqësorë kundrejt njerëzve dhe mund ti kafshojnë ata nëse nuk janë nën kontrollin e duhur. Një qen i lëshuar mund të jetë burim aksidenti nëse vrapon në rrugë dhe kjo mund ti shkaktojë dëmtime jo vetëm atij por edhe njerëzve të tjerë.
- Kafshët e braktisura në rrugë në mënyrë të vecantë qentë, përbëjnë një problem mjaft të madh për qytetin e BERATIT.. Numri i tyre është rritur këto vitet e fundit. Edhe pse është e vështirë të bësh një bilanc të saktë të numrit të kafshëve të braktisura në zonat urbane ,supozohet që ky numër të jetë afërsisht 300 qenë endacak. Rritja e numrit të tyre sjellë edhe rritjen e rasteve të sëmundjeve zoonotike, të cilat përbëjnë një rrezik serioz për shëndetin e popullsisë. Vlen të theksohet gjithashtu se qentë endacakë janë mbartësit kryesorë të sëmundjeve që vijnë nga parazitët.
- Eshtë e domozdoshme që të gjejme një zgjidhje për trajtimin e tyre, pasi rrugët janë të mbushura me qenë endacak.
- Për trajtimin e qenëve endacakë na ngarkon Ligji i Shërbimit Veteriner në Republikën e Shqipërisë nr.10465 datë 29.09.2011 i ndryshuar me ligjin nr 71 datë 04.06.2020, neni 24, shkronja c “V.K.M nr 475 date 30.07.2021, kreu III, pika 1 “Njësitë e vetqeverisjes vendore mbajnë nënkontroll lëvizjen e qenëve dhe maceve të rrugës”

Jemi ende shumë pas në mënyrën e trajtimit të kafshëve endacake, në lidhje me vendet e tjera europiane.

❖ **Pritshëmiret nga trajtimi i qenëve të rrugës.**

- Përmirësimi i situatës problematike të krijuar nga qentë endacakë në qytetin e Fierit, ulja e agresivitetit, rrezikshmërisë ndaj tyre dhe ajo që është më e rëndësishme përmirësimi i shëndetit publik.
- Reduktimi i sëmundjeve zoonotike duke siguruar një vaksinim të mundshëm i të gjithë qenve të rrugës, si dhe pajisjes së tyre me matrikull.
- Ulja e numrit të qenve dhe maceve endacake nëpër rrugë dhe ndalimi i shumimit të tyre nëpërmjet kastrimit, sterilizimit dhe jo vrasjes.
- Identifikimi dhe regjistrimi i qenve.
- Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit
 - Promovimi i një kulture të respektit për kafshët dhe jo dhunës ndaj tyre, me qëllim përmirësimin e raportit njeri kafshë.
 - Te frenojme fenomenin e braktisjes së kafshëve nga pronarët e tyre.
 - Të krijojmë një personel dhe vullnetarë, të cilët ti dedikojnë një pjesë të kohës së tyre përkujdesjes ndaj kafshëve .
- Afrojmë mundësi nxënësve të Shkollës së Mesme Profesionale Rakip Kryeziu Dega Veterinari, të kryejnë praktikat veterinare si dhe ti kemi vullnetare për qentë endacake.

Strategjia që do të ndiqet për të zgjidhur problemin e kafshëve të rrugës, është metoda KSVL(Kapja,Sterilizimi,Vaksinimi,Lëshimi) që këshillohet nga ËSPA (Ëorld Society for the Proctetion of Animals), dhe është një nga metodat më të sukseshme të kontrollimit dhe manzhimit të qenëve endacakë, që ka funksionuar në të gjitha vendet e zhvilluara sipas organizatave boterore si OBSH, OIE dhe Konventa evropiane për Mbrojtjen e kafshëve shoqërues nëpërmjet etapave të mëposhtme:

❖ **‘Kapja’**

Kapja e qenëve do të bëhet me mjete të specializuara (pushkë narkotike, rrjet ,lak) dhe dërgimi i tyre në ambjentet e Klinikës Veterinare, ku më pas do të realizohet:

- **Kontrolli klinik i tyre.**

Tek metoda KSVL,kapja duhet të bëhet nga persona të kualifikuar (të trajnuar) që ta bëjnë zënien e qenve me mënyra me të cilat kafsha nuk lëndohet apo vihet në stres, pa nevojë. Pas zënies, qeni endacak vendoset në makinën transportuese e cila duhet të përmbajë kushtet adekuate për transport të duhur të qenëve endacak, pranë klinikës veterinare për t’u përgatitur për operacion. Pasi qeni të transportohet në klinikën veterinare, ai futet në karantinë të klinikës, ku i bëhet një kontrollë i përgjithshme dhe diagnostifikohet nëse ka ndonjë sëmundje të rrezikshme ngjitëse për qentë e tjerë apo njerëzit.

❖ **Sterilizimi**

Pas periudhës para operacionale, qeni futet nën anestezi dhe përgatitet për kastrim apo sterilizim. Pas operacionit, qeni duhet të vendoset me kujdes për rehabilitim, në një boks/dhomë të

përshtatshme ku mund të lëvizë lirshëm. Lirimi i një qeni mashkull bëhet 3-5 ditë pas operacionit, qentë femra në varësi të operacionit..

❖ **Vaksinimi dhe dehelmintizimi**

Vaksinohet kundër tërbimit, gjë që është ligjërisht e kërkuar në vendin tonë dhe më pas kurohen për parazitë të brendshëm.

❖ **Matrikullimi**

Pasi janë vaskinuar dhe kuruar për parazitë qentë do të pajisen me një matrikull (numer identifikimi në vesh për ta dalluar nga qentë e tjere dhe për të informuar qytetarët se qeni nuk mbarështohet dhe që është i vaksinuar kundër tërbimit. I gjithë ky proces do të fotografohet dhe regjistrohet në një CD.

❖ **Lëshimi i qenit**

. Qentë duhet të leshohen në të njëjtin vend ku kapen, dhe lëshimi duhet të bëhet jo më vonë se 3-5 ditë pas kapjes, sepse përndryshe territori i mëparshëm mund të pushtohet nga qen të rinj që çon në përleshje midis qenëve.

Lëshimi saktësisht në vendin se ku është marrë është shumë i rëndësishëm, sepse qentë mësohen në një vend të caktuar dhe dinë ku të kërkojnë ushqim në lagjet ku janë rritur dhe po ashtu i njohin banorët përreth; kjo do të thotë që rreziku i sulmeve të tyre ndaj njerëzve është shumë i vogël, sepse janë mësuar në një lagje apo vend të caktuar.

I gjithë ky proces do të fotografohet dhe regjistrohet në një CD.

Qentë janë pjesë e komunitetit, ndaj i takon edhe komunitetit që t'i trajtojë mirë, pa dhunë dhe me dashamirësi.

Qentë që paraqesin agresivitet dhe sëmundje të rrezikshme, do të kontrollohen nga veterinerët dhe më pas merren masa për asgjësim, me metodën e eutanazisë me qëllim të mos shkaktoj dhimbje dhe vuajtje, kjo në bazë të ligjit të Shërbimit Veterinar në Republikën e Shqipërisë nr.10465 date 29.09.2011.

Gjithë procesi i trajtimit të kafshëve do të monitorohet nga Specialistët Veterinar të Bashkisë dhe numri i kafshëve që do trajtohen do të regjistrohen në një regjistër të veçantë.

PREVENTIVI I PËRAFËRT PËR SHËRBBIMIN E TRAJTIMIT TË QENËVE ENDACAKË SIPAS ZËRAVE ME OPERATORË PRIVATË

Nr	Emërtimi I shërbimit	Njesia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	Kapja, transporti dhe lëshimi	krerë	120	1 500	180 000
2	Sterilizimi, kastrimi	krerë	120	3 500	420 000
3	Vaksinimi, dehelmintizimi	krerë	120	1 000	120 000

4	Matrikullimi,regjistrimi,trajtimi I qenëve	krerë	120	800	96 000
	Vlera pa TVSH			6 800	816 000
	TVSH 20%			1 360	163 200
	VLEFTA ME TVSH			8 160	979 200

Konceptoi:

Guxim Toska (Specialist Veteriner)

Miratoi:

BLEDAR ÇILI (Drejtor Drejtorie)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Nr _____ prot

Berat, më

.2026

**“Relacion për miratimin e Planit Vendor të
Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028”**

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore është hartuar në mbështetje të Ligjit 139, Neni 54 pika K" .

Këshilli bashkiak miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ,

Planit i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026- 2028 i Bashkisë Berat, si një dokument strategjik vendor, synon përfshirjen e dimensionit gjinor në politikat, programet dhe shërbimet publike të bashkisë.

Në Bashkinë Berat, sfidat lidhur me barazinë gjinore mbeten të dukshme në disa aspekte të jetës sociale dhe ekonomike, si:

- përfaqësimi i kufizuar i grave në vendimmarrje,
- pjesëmarrje më e ulët në tregun e punës,
- ndarja e pabarabartë e roleve në familje,
- dhuna me bazë gjinore;

Ky Plan është hartuar në mënyrë pjesëmarrëse, në bashkëpunim me përfaqësues të komunitetit, institucione vendore, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë zhvillimi. Ai mbështetet në të dhëna konkrete dhe identifikon objektiva strategjike si:

- forcimi i kapaciteteve të strukturave vendore për integrimin gjinor,
- promovimi i punësimit të grave dhe grave sipërmarrëse,
- përmirësimi i aksesit në shërbime të ndjeshme gjinore,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

rritja e ndërgjegjësimit në komunitet për çështjet e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës.

Çdo masë do të ketë planifikim buxhetor të integruar sipas viteve, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe zbatueshmërisë së planit Duke qenë se barazia gjinore është një parim themelor për zhvillimin demokratik, përfshirës dhe të qëndrueshëm të bashkisë, si dhe një angazhim kombëtar dhe ndërkombëtar i Shqipërisë, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i Beratit i Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026— 2028.

Miratimi i këtij dokumenti do t'i japë bashkisë Berat një bazë të fortë për veprime konkrete në drejtim të përmirësimit të jetës së grave dhe burrave në komunitet..

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi :Drejtorja e Shërbimit Social, Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe te Ardhurave, Drejtorja Juridike , Drejtorja e Turizmit dhe Aktiviteteve, Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbëshetëse, Drejtorja e Planifikimit urban, lejeve dhe monitorimit te investimeve, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave, Drejtorja e Emergjencave, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtorja e Arsimit. Drejtorja e Integritimit European dhe Zhvillimit Strategjik, Drejtorja e Arsimit, Kultures dhe Rinisë, Agjensia e Shërbimeve Publike, Drejtorja e Bujqësisë, Adiministrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar.

K R Y E T A R I

Ervin CECA

Konceptoi: J.Qevani

Miratoi: P.Xheblati